



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE

LËNDA:

GJUHË SPANJOLLE

PROVIM ME ZGJEDHJE (Niveli B2)

Viti shkollor 2017 – 2018

Koordinatorë: Ludmilla Stefani, Viola Karapici

1. HYRJE

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës spanjolle, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën spanjolle si lëndë me zgjedhje, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Niveli i njohurive i përket nivelit **B2** sipas dokumentit evropian “Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët”.

Ky program duhet të nxisë inspirim dhe sfidë për të gjithë nxënësit dhe t’i përgatisë ata për të ardhmen. Programi orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, si dhe zhvillimet e tyre personale.

2. SYNIMET E PROGRAMIT

Ky program synon:

-) *Të ndihmojë nxënësin në përgatitjen e tij për provimin e maturës në gjuhën spanjolle.*
-) *Të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve.*
-) *Vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy konceptet bazë, që janë: **të lexuarit dhe të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.***
-) *Të japë orientime për specialistët e gjuhës spanjolle që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore.*
-) *Vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, aftësinë për të përdorur gjuhën që është e përshtatshme për spanjishten standarde (në aspektin e saj morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional).*
-) *Aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme me situata komunikimi të dhëna.*

3. UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato.

Kur flitet për tematikën kryesore në program (p.sh:” Pimeras impresiones”) kjo nuk do të thotë që në provim do të ketë pasazhe nga mësimet që ka në libër (p.sh La vida de Marcelo Colon y su trabajo como director de operaciones de la compania Xcelens, etj). Në provim do të dalë jeta e një figure tjetër të shquar në atë fushë. Kështu që mësuesi duhet t’i përgatisë nxënësit që të kenë njohuri dhe një bagazh të konsiderueshëm leksikor për temat që janë të përfshira në program.

Përsa i përket gramatikës, mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi një problem të caktuar gramatikor (voz pasivo, condicional, diferencia entre ser y estar, tiempos verbales, combinaciones de los tiempos pasados, frases complejas, preposiciones, etj,) duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale që jepen nëpër tekste dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh ku të përfshihen këto aspekte gramatikote, duke e parapërgatitur nxënësin për ato çka do trajtohen në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Mësuesi duhet të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Në to duhet të ndihet rëndësia dhe ndikimi i madh që ka të mësuarit dhe të folurit e gjuhës spanjolle.

Për sa i përket të shkruarit mësuesi duhet ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë fjalët në fjali, fjalitë në paragrafë dhe paragrafët në një ese’. Gjithashtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij në një tekst koherent.

4. AFTËSITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS NË GJUHËN SPANJOLLE SI LËNDË ME ZGJEDHJE.

Nxënësi i ushtrohet provimit të Maturës në Gjuhën spanjolle duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij si më poshtë vijon:

Të kuptuarit me shkrim

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen ushtrime kuptimore.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë globale tekste për të gjetur informacionin e kërkuar; për të mbledhur informacionet që i kërkohen nga pjesë të ndryshme të një teksti, apo tekste të ndryshme për të përmbushur një detyrë të caktuar.

Në një pjesë leximi nxënësi duhet të dallojë faktin nga opinioni, duke përdorur informacion të saktë, argumente dhe pikëpamje që të jenë koherente.

Është e rëndësishme që ai të dallojë informacionin thelbësor nga ai i parëndësishëm, duke vendosur kritere për gjykim, analizë dhe nxjerrje konkluzionesh rreth një çështje të caktuar.

Në mënyrë të përmbledhur kjo aftësi përfshin:

-) kuptimin global të tekstit,
-) kuptimin selektiv: gjetjen e informacioneve specifike,
-) përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit,
-) kuptimi i thelluar: gjetja e të pashprehurës ose të nënkuptuarës, qëndrimin e autorit, etj.,
-) plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit,
-) kryerja e ushtrimeve gramatikore rreth tekstit,
-) gjetjen e fjalëve referuese (kujt i referohet ky përemër në fjali),
-) formimin e një kuptimi të përgjithshëm,
-) reflektimi mbi përmbajtjen e një teksti dhe vlerësimi se sa me vend janë disa elemente të informacionit,
-) zhvillimi i aftësisë interpretuese duke bërë një përfundim logjik,
-) gjetja e një informacioni sinonim,
-) zhvillimi i aftësisë interpretuese duke bërë identifikimin dhe paraqitjen e elementëve provues,
-) reflektimi mbi përmbajtjen e një teksti duke u bazuar mbi disa vlera dhe bindje për të dhënë një gjykim në lidhje me moralin e historisë.

Të shprehurit me shkrim

Në provimin e maturës nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë të gjerë temash duke i lidhur elementët në mënyrë lineare, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar,

të tregojë një histori, të shkruajë ese' mbi tema të ndryshme, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, të bëjë komentin e një filmi qartë, të shkruajë një informacion duke u nisur nga shënimet e marra etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **200-250 fjalësh**, në të cilin duhet të zhvillojë një temë mbi një çështje me interes të përgjithshëm e duke marrë shkas nga pjesa e panjohur ose që nuk ka lidhje me të. Nxënësi do të vlerësohet për: përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore si dhe strukturën e koherencën.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

-) të shprehurit me shkrim për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar në librat e katër viteve,
-) një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë (letër formale ose joformale, paragraf përshkrues),
-) lidhjen në mënyrë koherente të informacioneve nga burime të ndryshme,
-) shprehjen e pikëpamjeve në formë të argumentuar,
-) përdorimin e një repertori të gjerë leksikor,
-) koment me shkrim për probleme të ndryshme,
-) të dijë të organizojë mirë përmbajtjen e punës me shkrim duke qenë gjithnjë në koherencë me temën e dhënë,
-) të vendosë dhe të ruajë një këndvështrim të vetin dhe origjinal për temën mbi të cilën do shkruajë,
-) të shkruajë paragrafë të plotë në të cilët të ketë detaje dhe informacione specifike për temën e dhënë,
-) të ruajë rendin e mendimeve në gjithë pjesën e shkruar, të përdorë tipe dhe gjatësi të ndryshme fjalish.

Përdorimi i gjuhës

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë, janë të dhëna përmes **fushës tematike** të mëposhtme, e cila është e ndarë në linja dhe nën-linja sipas tematikës së zhvilluar dhe **elementëve gramatikorë**, të cilët zhvillohen në mënyrë spirale gjatë viteve të shkollës së mesme dhe jepen të detajuara në program.

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar janë dhënë përmes **akteve dhe funksioneve komunikative**. Ato tregojnë se cilat janë shprehitë kryesore që një nxënës ka fituar përmes realizimit të programit lëndor dhe që ai është i aftë të shprehë.

5. TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA PËR ÇDO FUSHË

Të kuptuarit me shkrim	
<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Pyetje mbi përmbajtjen e tekstit <input type="checkbox"/> Ushtrime me vende bosh <input type="checkbox"/> Ushtrime me zgjedhje fjalësh ose frazash <input type="checkbox"/> Ushtrime me përgjigje po/jo <input type="checkbox"/> Ushtrime me e vërtetë/e rreme <input type="checkbox"/> Ushtrime me disa alternativa <input type="checkbox"/> Gjetja e idesë kryesore <input type="checkbox"/> Renditje paragrafësh sipas logjikës dhe koherencës <input type="checkbox"/> Gjetja e një informacioni sinonim 	
Përdorimi i gjuhës (Fjalor dhe Gramatikë)	
<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Ushtrime me zëvendësim <input type="checkbox"/> Ushtrime transformimi <input type="checkbox"/> Ushtrime me shumë zgjedhje/ alternativa <input type="checkbox"/> Ushtrime me plotësime vendesh bosh <input type="checkbox"/> Ushtrime me ndërtim fjalish <input type="checkbox"/> Ushtrime me bashkim fjale me kuptimin <input type="checkbox"/> Ushtrime me gjetje gabimesh, bashkim funksioni me strukturën përkatëse, etj. 	
Të shkruarit	
<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Radhitje paragrafësh sipas koherencës <input type="checkbox"/> Letër (formale/joformale), email, kartolinë <input type="checkbox"/> Hartim i një dialogu për një temë të caktuar <input type="checkbox"/> Përmbledhje, koment 	

-) Ese
-) Radhitja e fjalive në paragraf
(ushtrimi i tipit *ese e shkurtër* të jepet në njërin nga testet)

6. STRUKTURA E PROVIMIT NË PËRQINDJE

FUSHAT	Përqindja
Të kuptuarit me shkrim	40 %
Përdorimi i gjuhës (gramatika dhe leksiku)	40 %
Të shkruarit (ese ose krijim, një letër, kërkesë, përshkrim, artikull, përmbledhje, etj.)	20 %

7. NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI

Fushat tematike dhe leksiku

Kjo rubrikë e programit grupon linjat kryesore si edhe nënlinjat, të cilat janë të përbashkëta për mësimin e gjuhës së huaj. Ato reflektojnë interesat dhe motivimin e nxënësve dhe rrokin gjithë sferën e marrëdhënieve *familje-shoqëri-nxënës*; sferën publike dhe sferën profesionale si edhe aspektin kulturor e qytetërimin.

Përmbajtja tematike është mbështetur në programin e zhvilluar në shkollën e mesme si edhe në tekstet shkollore për gjuhën spanjolle. Tematika e mëposhtme, e parashikuar për provimin e maturës, do të përfshijë temat bazë (sipas kurrikulës) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Temat janë formuluar në mënyrë përgjithësuese e jo sipas titujve të teksteve dhe përfshijnë ato njohuri të cilat janë zhvilluar përmes mësimëve.

Yo mismo

-) datos personales.
-) el cuerpo
-) la higiene.

-) la salud y el estado de ánimo.
-) la ropa.
-) la actividad cotidiana.

El mundo personal

-) la familia.
-) la casa.
-) la comida.
-) los amigos.
-) la alimentación y la salud.

El entorno social.

-) la escuela.
-) el tiempo libre.
-) la naturaleza y el ambiente.
-) lugares públicos.
-) viajes y vacaciones, reservas por internet
-) ecología, movilización.

Tradiciones y celebraciones

-) fiestas populares.
-) carnavales.
-) boda.
-) El flamenco.
-) corridas de toros etc.

El mundo de la información y de la cultura

-) la prensa y escribir artículos de opinión.
-) el teatro, el cine y escribir una sinopsis.
-) el desarrollo de la tecnología.
-) la cultura de los países de Hispanoamérica.

Productos y servicios

-) reclamaciones.
-) empresas.

-) nutrición.
-) publicidad.
-) solicitud de trabajo.
-) horarios de trabajo.

El medio ambiente

-) problemas urbanos.
-) ciudades y aldeas.
-) el clima.

Leksiku

Programi ka karakter tematik. Në bazë të temës, përzgjidhet dhe integrohet në të përmbajtja leksikore e domosdoshme, aktet gjuhësore si edhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e komunikimit. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për të përballuar me sukses dhe për t'u shprehur lirshëm me shkrim.

Aktet dhe funksionet komunikuese

Sugjerohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, të cilët shërbejnë si mënyrë orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve. Aktet dhe funksionet komunikative japin shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar ndër vite.

-) Expresar opiniones.
Ej: Yo creo, opino, considero ... que; Afirmo ..que;
-) Contar hechos, narrar.
Ej: Al + infinitivo; Lo de... ; En cuanto a...; Seguir + gerundio.
-) Expresar sentimientos, puntos de vista.
EJ: En mi opinión...; Desde mi punto de vista...
-) Comunicarse mediante cartas.
Ej: ir + gerundio; Dar cuenta de; Encabezamientos, despedidas.
-) Informar de manera impersonal.
Ej: se dice..; se habla..
-) Estructuras propias del debate.
Ej: O sea..; ? Le importaria...? A ver...
-) Establecer comparaciones.

- Ej: igual que..; tan ..como; tanto como; como si
-) Expresar posibilidad y probabilidad.
Ej: Es probable, posible ... que.
 -) Expresar deseos futuros.
Ej: ¡Que+ subjuntivo!; A lo mejor+ verbo.; Suponiendo +verbo.
 -) Referir lo dicho por otros.
Ej: Dice/ Dijo que + verbo.; Dice que hable Ud.
 -) Expresar opinion sobre el futuro.
Ej: ¡Ojala + verbo!.

Elemente dhe struktura gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, si me gojë ashtu edhe me shkrim, sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore të mëposhtme:

-) El verbo en indicativo.
-) Los verbos regulares e irregulares de las tres conjugaciones.
-) Los verbos auxillares. El infinitivo, el gerundio, el participio, etc.
-) Los tiempos del pasado (el indefinido, el imperfecto, el pluscuamperfecto).
-) El condicional simple y compuesto.
-) El presente del subjuntivo.
-) El pretérito perfecto e imperfecto del subjuntivo.
-) La diferencia entre subjuntivo e indicativo.
-) Verbos con preposiciones.
-) Ser y estar.
-) Expresar casualidad.
-) Expresar concesión.
-) Expresar finalidad.
-) Expresar causalidad.
-) Expresar condicionalidad.
-) Los prefijos y los sufijos mas importantes.
-) El nombre.
-) El pronombre.

-) El artículo.
-) El adjetivo.
-) El adverbio.
-) Estilo directo y estilo indirecto.
-) Verbos reflexivos.
-) Los pronombres de complemento directo e indirecto.
-) El imperativo.
-) La voz pasiva.